

Ymer
Minxhozi

DARKË ME PERANDORIN

BIBLIOTEKA
SHTETIT




Fejtone

85H-4
M 48

Ymer
Minxhozi

DARKË
ME
PERANDORIN



Fejtone

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

INTERVISTË ME MARK TUENIN

— Zoti Tuen! A do të dëshironit t'u përgjigjeshit disa pyetjeve për Amerikën e sotme?

— Të gjitha mendimet e mia për Amerikën unë i kam lënë me shkrim, qoftë ajo e djeshme, apo e sotme. Megjithatë, jam gati t'ju dëgjoj.

— Mendoj se intervista jonë duhet të fillojë me një pyetje nga gjeografia. A do të ishit dakord?

— Me gjithë qejf. Ne amerikanët e duam aq shumë gjeografinë, sa që do të na pëlqente ta mbanim globin vazhdimisht nën sjetull. Kjo ka bërë që simpatia dhe njohuritë tona për gjeografinë të shkojnë aq larg, sa t'i konsiderojmë Mesdheun tuaj dhe ishujt e Oqeanit Indian si krahinat tona.

— Kjo do të thotë se ju i vlerësoni shumë zbulimet e mëdha gjeografike të të gjitha kohëve?

— Të gjitha zbulimet gjeografike kanë qenë arritje të mëdha, por ato do të ishin shumë më të dobishme për njerëzimin sikur Kolombi, gjatë udhëtimeve të tij, të mos e vinte re fare Amerikën.

— Tani, në qoftë se më lejoni le të hidhemi në politikë. Sipas mendimit tuaj, cilat janë gjërat më të çmueshme që gëzoni ju amerikanët?

— Me ndihmën e perëndisë, ne në Amerikë kemi marrë tri dhurata të paçmueshme: lirinë e fjalës, lirinë e ndërjegjes dhe gjykimin e shëndoshë që s'na lejon të gabojmë e t'i përdorim ato.

— A mund të na thoni me pak fjalë, përse dy partitë më të mëdha të borgjezisë amerikane kanë zgjedhur si simbole të tyre dy kafshë: njëra gomarin dhe tjetra elefantin?

— Një zgjedhje më e përshtatshme se kjo as që mund të mendohet, pasi këto dy simbole e plotësojnë për bukuri njëra-tjetrën: gomari — intelektin, elefanti — oreksin e bankierëve të të dyja partive.

— Mos është i lidhur me këto kafshë fakti që në zgjedhjet amerikane dëgjohet aq shumë zëri i këtyre dy partive?

— Teneqet boshe bëjnë gjithmonë zhurmë, sidomos kur ato janë dy a më shumë dhe përplasen me njëra-tjetrën.

— Të gjithë thonë se Partia Republikane dhe Partia Demokratike janë dy maska të së njëjtës fytyrë. Përse atëherë grinden ato midis tyre?

— Ujqit grinden jo vetëm me njerëzit, por edhe midis tyre. Sidomos kur është fjala për dashin më të majmur.

— Nuk mund të na jepni një përcaktim më të saktë për zgjedhjet në Amerikë, për të cilat bëhet aq bujë?

— Ato janë karnavali më i kushtueshëm në shkallë kombëtare, ku njerëzit kujtojnë se po kryejnë detyrën patriotike, ndërsa tallen me veten e tyre.

— Në qoftë se nuk më tradhton kujtesa, ju

keni dhënë një përcaktim për senatorët tuaj, si figura imponante të jetës politike amerikane.

— Po, është e vërtetë. Dikur unë kam shkruar këto fjalë: «Senatori është një njeri që voton ligje në Uashington gjatë kohës që nuk ndodhet në burg për fajë kriminale».

— Meqenëse jemi te senatorët, sipas jush, a ka senator që nuk mund të blihet me para?

— Ka. Ata që janë shitur me kohë.

— Thuhet se ju keni shprehur disa mendime origjinale edhe për bankierët e Uollstritit. Çfarë keni thënë konkretisht për ta?

— Për bankierët kam mendimin se janë qenie tepër të ndjeshme dhe humanitare. Bankier i vërtetë është ai që jua jep çadrën kur shkëlqen dielli dhe jua merr atë pikërisht në çastin kur fillon shiu.

— Presidentët tuaj flasin shpesh, por e përdorin shumë rrallë të vërtetën në fjalimet e tyre. A mund të na e shpjegoni, përse ndodh kjo?

— Kjo vjen sepse politikanët tanë e vlerësojnë të vërtetën si gjënë më të shtrenjtë, prandaj e përdorin atë me shumë ekonomi, ose e kursejnë fare.

— Në vlerësimet e shtypit të huaj presidenti amerikan na paraqitet herë si matrapaz, herë si mashë dhe herë të tjera si kamxhik. A mund të na thoni se cili nga këto përcaktime është më i drejtë?

→ Për herë të parë në jetën time po jap një përgjigje prej oportunisti: të gjithë kanë të drejtë!

— Si shpjegohet fakti që të gjithë presidentët tuaj i harrojnë shpejt premtimet e bëra gjatë fushatës së zgjedhjeve?

— Përgjithësisht gënjeshtari ka nevojë për kujtesë të fortë, mirëpo në rastin e dhënë duket se kemi të bëjmë me një sklerozë mjaft të përparuar.

— Edhe një pyetje që ka të bëjë me një person konkret: Si i vlerësoni ju cilësitë sportive të presidentit Karter, i cili kohët e fundit mori pjesë në një garë vrapimi në Kemp Devid?

— Meqenëse Karteri të gjitha garat e tjera i ka humbur, tani atij s'i mbetet tjetër veçse t'ua mbathë këmbëve. Mendoj se në këtë drejtim ai ka ende forca e aftësi të pashfrytëzuara.

— Në kujtesën e lexuesit ruhet pamfleti juaj për shtypin amerikan. Mendoni se kanë ndodhur ndryshime në gazetat amerikane gjatë kësaj kohe?

— Letra është përmirësuar mjaft, por ajo vazhdon të durojë, si edhe më parë.

— Përsëri lidhur me shtypin. Përse disa pronarë gazetash të ju i quajnë mbretër?

— Kjo ndodh sepse marrëzia mund të mbretërojë edhe pa fron.

— Po për gazetarët amerikanë, çfarë mund të thoni?

— Përgjithësisht s'dua të kem asnjë punë me ta. Vetëm dua të theksoj se për të qenë papagall s'është e domosdoshme të flasësh. I tillë mund të bëhesh edhe me shkrim.

— Pyetja e fundit: Çfarë do t'i dhuronit Amerikës së sotme?

— Sapun e peshqir, por jo pasqyrë.

— Mos e keni fjalën për skandalin e famshëm të Uotergejtit?

— Më falni, por mua më duhet të largohem menjëherë. Me siguri e gjithë biseda jonë është incizuar. Lamtumirë!

1979

SHKENCA E MREKULLIVE

Unë gjithmonë kam vrarë mendjen të mësoj se si përcaktohet qytetari mesatar, për të cilin aq shumë flitet e shkruhet në shtypin e huaj, sidomos sa herë bëhen bilancet vjetore. Megjithëse statistika është një shkencë shumë konkrete, deri tani së fundi unë nuk e kisha kuptuar përse, për shembull, këmba e qytetarit mesatar amerikan, francez apo italian, të mos shprehej me një numër të plotë, por gjithmonë me një tepriçë prej disa të qindta të milimetrit, ose përse flokët e tij të mos jenë as të zez, as të verdhë, por me një ngjyrë që anon nga një nuancë në tjetrën e që s'është as njëra e as tjetra? Madje edhe fëmijët e qytetarit mesatar gjithmonë janë me fraksione — ai nuk ka një, dy, tre, apo katër fëmijë, por gjithmonë ose një e shtatë të qindtat ose dy e gjashtë të qindtat e fëmijës e kështu me radhë. Të kuptohemi. Nuk dua në asnjë mënyrë të vë në dyshim ekzistencën e qytetarit mesatar, sepse, derisa e thotë statistika një gjë të tillë, ajo duhet pranuar mbasi statistika flet me

fakte në dorë. Në qoftë se shifrat thonë se ti nuk ke një apo dy fëmijë por pikërisht një e gjysmë apo një e tri të katërtat e fëmijës, ose ke 0,3 për qind të radios dhe 0,13 të qindtat e televizorit, atëherë ashtu duhet të jetë me të vërtetë.

Me siguri, po të mos ishte statistika mesatare, as që do të mund të takoheshin, bie fjala, Rokfeleri me disa miliardë dollarë dhe plaku Denald Bruks, që e nxjerr ushqimin duke gërmuar në mbeturinat e qytetit. Meqenëse ekziston mesatarja statistikore, ata i ndajnë të ardhurat përgjysmë dhe plaku Bruks është jo vetëm lypës, por edhe milioner. Shkurt të themi, ti mund t'i kesh këmbët në furrë dhe kokën në frigorifer, por mesatarja do të tregojë një temperaturë normale të organizmit.

Kështu, kjo shkencë e mrekullive ka arritur të krijojë një tip të përkryer, qytetarin me përmasa të llogaritura fiks deri në të qindtat e centimetrit. Le të ketë, bie fjala, dhjetë milionë analfabetë në Amerikë, mirëpo ata (gjithmonë sipas mesatares) të gjithë lexojnë nga një libër në vit. E shikoni pra? Me një të lëvizur të lapsit, mesatarja i bën analfabetët të lexojnë një libër të tërë!

Kur Antonio Faxhioli, një banor i bidonvileve të Napolit, mori vesh se edhe ai ishte një qytetar mesatar i vendit të tij, thirri të shoqen gjithë entuziazëm:

— Antoneta! Më në fund edhe ti do të kesh shërbyese. Bile e ke që tani.

— Unë ve'ë jam shërbyese, — përgjigjet Antoneta.

— Jo, jo, ti me siguri diku e ke fshehur një të katërtën e shërbyeses.

— Antonio, mos ke lajthitur?

— Unë s'kam lajthitur, por po të them ato ç'ka thotë statistika. Në këtë koliben tonë prej te-

neqeje prej kohësh lëviz fantazma e një shërbëto-reje, por ne nuk e kemi parë deri më sot.

— Unë thashë se ke gjetur ndonjë kuletë me para, për sa i përket statistikës, s'kam asnjë punë me të.

— S'ke ti, po kanë ata me ty. Dhe ti nuk zotëron vetëm një të katërtën e shërbyeses, por edhe 0,30 të makinës fshirëse, 0,23 të makinës larëse...

— Antonio, më duket se po flet përçart!

— Dikush është përçart: ose ne që i lexojmë, ose ata që shkruajnë, por fakti është se ti nuk je 1,75 centimetra e gjatë, por 1,82 dhe këmbën e ke jo 37 por 38,07, flokët nuk i ke të zez, por disi bojë kafe dhe disi...

— Domethënë të paskam fshehur dhe gjatësinë...

— Ti më ke fshehur jo vetëm gjatësinë, por edhe faktin që ne mbajtkemi në kuzhinë 0,32 të frigoriferit dhe 25 për qind të lavastoviljes. Nga pesë pjata që kemi, dy janë prej fajance dhe jo të gjitha prej balte, ndërsa njërin ti e lan me lavastovilje.

— Ashtu qoftë, i dashur Antonio, por ne nuk kemi as kuzhinë dhe përveç teje dhe tre fëmijëve unë s'di të kem tjetër gjë.

— Ti je qytetare e mesme, Antoneta, dhe si e tillë nuk ke tre fëmijë, por vetëm 2,1 dhe unë e ti nuk jemi plotësisht të martuar, pasi mesatarisht ne jemi vetëm gjysmë të martuar.

— Antonio, mblidhe veten, unë s'lejoj të më preken fëmijët dhe as ndahem prej teje!

— Ashtu thua ti, por statistika demografike thotë se ti ke pasur edhe një burrë tjetër para se të më merrje mua.

— Unë, burrë tjetër?! Antinio!

— Mesatarja thotë se çdo grua është ndarë një herë.

— Antonio! Mblidhe veten!
— Derisa je qytetare mesatare...
— Mblidhe veten, Antonio, ne të bidonvileve nuk futemi në mesatare!

— Edhe ne, Antoneta, edhe ne. Bile ti nuk banon në një barakë prej teneqeje, por në katin e mesëm të një ndërtese mesatare prej tullash e betoni, e cila ka edhe 0,03 të ashensorit. Ti mund të thuash se ne e mbushim ujin në një çezmë që u shërben edhe dyqind familjeve të tje-
ra, ndërsa statistika e thotë qartë se ti je pronare e 0,01 të pishinës.

— Kjo do të thotë se tani e tutje do të na japin edhe pishinë?

— Patjetër. Statistika e thotë troç, se pronari i ndan njëllorj të ardhurat me ne dhe se neve, si familje, na takon edhe një vidhë e aeroplanit të tij personal e kështu, me këtë vidhë, do të mund të fluturojmë edhe ne ku të duam.

Antoneta heshti dhe e vështroi të shoqin me keqardhje.

— Sipas këtyre statistikave, ti duhet të jesh arrestuar të paktën një herë në vit, — i tha ajo Antonios.

— Unë i arrestuar?! — thirri burri.

— Pikërisht ti! — nguli këmbë Antoneta. Komshiu përkarshi arrestohet dy herë në vit për vjedhje. Mesatarisht si i bie?

Antonioja shtangu në vend.

— Leri marrëzitë, Antonio! — i thotë grua-
aja. — Ti më mirë kujdesu për Françeskon e vo-
gël të mos na e kafshojë ndonjë mi, se dje
kam parë hatanë me sy. Djalin e Robertos e
kishte kafshuar miu në hundë dhe s'dihet a
shpëton.

Dhe me të vërtetë, pa e mbaruar mirë fja-
lën Antoneta, Françeskoja njëvjeçar dha alar-